

VENDIM
Nr.590, datë 31.8.2006

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.9588, DATË 25.7.2006 “PËR RILLOGARITJEN
E PENSIONEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.9588, datë 25.7.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Rillogaritjen e pensioneve të caktuara nga data 1.1.1994 deri më 31.12.1996.

1. Në zbatim të nenit 2 të ligjit nr.9588, datë 25.7.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”, pensioneve, që kanë datë fillimi nga data 1.1.1994 deri më 31.12.1996, përfshirë edhe këtë datë, u indeksohet paga mbi të cilën është llogaritur baza e vlerësuar dhe paga neto, për periudhën nga data 1.1.1994 deri në datën e fillimit të pensionit individual por, në çdo rast, brenda periudhës 1.1.1994 deri më 31.12.1996.

2. Indeksi bëhet sipas procedurave dhe koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar individuale, pas vitit 1994, sipas viteve, përcaktohen në vendimin nr.400, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual për llogaritjen fillestare të pensioneve”.

3. Rillogaritja e masës së pensionit dhe indeksimet bëhen në bazë të pagave të dokumentuara e të paraqitura në dosjen individuale të pensionit dhe mbi të cilat është caktuar masa e pensionit fillestar.

II. Rillogaritjen e pensioneve të caktuara nga data 1.1.1997 deri më 14.6.2005.

1. Në zbatim të nenit 3 të ligjit nr.9588, datë 25.7.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”, pensioneve, që kanë datë fillimi nga data 1.1.1997 deri më 14.6.2005, përfshirë edhe këtë datë, u rillogaritet baza e vlerësuar, sipas nenit 59, dhe u indeksohet paga neto, sipas nenit 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Për periudhën e sigurimit para datës 1.1.1994, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar, përdoren pagat referuese, të përcaktuara në vendimin nr.561, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës referuese për llogaritjen e pensioneve”.

3. Nga data 1.1.1994 dhe deri më datën e fillimit të pensionit këto paga do të indeksohen me koeficientin e indeksimit të vitit përkatës, të përcaktuara në vendimin nr.400, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”.

4. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 dhe deri në datën e fillimit të pensionit, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar, merren pagat mbi të cilat janë paguar kontributet, të indeksuara me koeficientin e indeksimit të vitit përkatës, sipas përcaktimeve të vendimit nr.400, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”.

5. Paga neto e tri viteve rresht, në dhjetë vitet e fundit të punës, rillogaritet duke përdorur të njëjtët koeficientë indeksimi, si edhe për rillogaritjen e bazës së vlerësuar.

6. Periudhat e sigurimit pas datës 1.10.1993, të njohura të vlefshme për efekt llogaritjeje pensioni, por të pashoqëruara në kohën e caktimit të pensionit me dokumentin që vërteton pagën për çdo muaj, duke u bazuar në nenin 60 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nivel minimal.

III. Masa e re e pensionit, e rillogaritur sipas krerëve I dhe II, të këtij vendimi, rritet radhazi, sipas përqindjeve të rritjes së pensioneve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, për rritjen e pensioneve, por, në çdo rast, për periudhat nga data e caktimit të pensionit individual e deri në datën 1.7.2006, përfshirë edhe rritjen e caktuar me vendimin nr.399, datë 21.6.2003 të Këshillit të Ministrave “Për rritjen e pensioneve”.

Masa e pensionit, që rezulton pas rillogaritjeve dhe zbatimit të rritjeve, është masa përfundimtare e pensionit individual. Kur kjo masë pensioni rezulton më e vogël se pensioni ekzistues,

atëherë nuk ndryshon, duke u vlerësuar si e drejtë e fituar.

IV. Efektet financiare, për vitin 2006, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 465 000 000 (katërqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, nga të cilat 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë shpenzime administrative, dhe përballohen nga fondi i kontigjencës së Këshillit të Ministrave dhe nga fondet shtesë, të përcaktuara në ligjin nr.9601, datë 28.7.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006””.

V. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha